

Nr.19

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR KLIMATIK

Korrik 2018

Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2018





BULETINI MUJOR KLIMATIK

Korrik 2018

Nr. 19

Përmbledhje. Muaji Korrik 2018 dallon në pikëpamje të historisë klimatike për vërtetimin e rrufeve në nivele të larta. Ky muaj u karakterizua me temperatura mesatare të ajrit me vlera pranë ose mbi normë me rreth $+0.9^{\circ}\text{C}$. Vranësirat ishin të pranishme në shumicën e ditëve, ndërsa reshjet e regjistruara ishin në sasi rreth 26% më të larta se norma. Ato u vërtetuan në një numër ditësh me reshje mbi pragun 1.0mm më të madh se norma me rreth 33% më shumë. Nuk u vërtetuan dukuri ekstreme apo zjarre në pyje, karakteristike për këtë muaj.

Summary. July 2018 differs in terms of climatic history for the observation of lightning strikes at high levels. This month was characterized by an average air temperature close to or above the rate of about $+0.9^{\circ}\text{C}$. Cloudiness were present on most days, while precipitation rates were about 26% higher than the norm. They were observed in a number of days with rainfall above the 1.0mm threshold that the norm value by about 33% more. No extreme phenomena or forest fires were observed, characteristic for this month.

SITUATA SINOPTIKE

Në dy ditët e para të këtij muaji dominoi një anticiklon. Për pasojë, në pjesën më të madhe të vendit nuk pati reshje, përjashtuar zonat malore në veri, ku u vërtetuan reshje lokale me karakter konvektiv për shkak edhe të “forcing”-ut të shkaktuar nga ngrohja e sipërfaqes së tokës gjatë pasditeve.

Në ditët e tjera të muajit ky konveksion i pasditeve ka qenë i pranishëm në të gjithë territorin.

Më konkretisht, në datat 3-4 ky konveksion favorizohet edhe nga fakti se në shtresat e ulëta të atmosferës kishte lëvizje vertikale të forta, duke gjeneruar edhe erë të fortë momentale dhe breshër. Ky konveksion në disa zona vijoi edhe gjatë natës, ndonëse më i dobët. Pozicioni i

saj demonstrohet me një vijë paqëndrueshmërie që kalon në Veri të vendit, pasqyruar në figurën Nr.1).

Figura Nr.1 - Situata sinoptike e datës 4 korrik 2018, 12:00 UTC (Met Office).

Rreth datës 7 një kreshtë në sipërfaqen 500 hPa, e cila shtrihej nga Mesdheu Perëndimor deri në Detin e Veriut, filloi të dobësohej, duke lejuar që të hynin në Evropë disa formacione në formë lugine, ndërmjet tyre edhe një mbi Ballkan. Kjo e fundit favorizoi shumë shtrëngata. Pozicioni i saj demonstrohet me një vijë paqëndrueshmërie që gjeneroi reshje, sidomos në Veri dhe Veri-Lindje, e cila jepet në figurën Nr.2).





Figura Nr.2 - Situata sinoptike e datës 7 korrik 2018, 12:00 UTC.

Do të veçonim edhe datat 16-17: ku një luginë në shtresat e mesme të atmosferës lëvizi shpejt nga Gadishulli Iberik drejt Italisë dhe më tej deri në Ballkan, duke prodhuar lëvizje vertikale në zona shumë të gjera gjeografike dhe duke tërhequr edhe masa ajri të paqëndrueshme nga Afrika dhe masa ajrore të shtresave të ulëta të ngarkuara me lagështirë nga Mesdheu Verior. Kjo

situatë gjeneroi reshje, por edhe breshër me dimensione të mëdha dhe erë të fortë momentale.

Një pamje tipike e motit të veçantë ndër vite, gjatë pasditeve në Tiranë, përgjatë muajit korrik 2018, jepet në figurën Nr. 3.




Figura Nr.3 – Numri i rrufeve të vrojtuar gjatë një periudhe kohore 2 orëshe (majtas) si dhe pamje panoramike e qiellit mbi Tiranë (djathtas), datë: 25 korrik 2018 ora 17:30 me vranësirë, rrufe, reshje intensive me kohëzgjatje të shkurtër, karakteristike për mjaft pasdite gjatë muajit korrik 2018 dhe në veçanti në pjesën lindore të kryeqytetit (foto: P. Zorba).

KARAKTERISTIKAT KRYESORE METEOROLOGJIKE TË MUAJIT: KORRIK 2018 DHE DISA KONSIDERATA MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE

TEMPERTATURAT E AJRIT – gjatë muajit korrik 2018, shënuan vlera pranë normës ose lehtësisht mbi normë pothuajse në të gjithë territorin e vendit tonë. Ato ruajtën vlera të moderuara sa i takon madhësive maksimale ditore, si rezultat i mbizotërimit të motit me vranësira e reshje në mesditë. Të dhënat për temperaturat minimale, maksimale dhe mesatare të ajrit, më të detajuara pasqyrohen në grafikët në vijim në figurat Nr. 4 dhe Nr.6/1÷6/12.

Pas një përpunimi të kujdesshëm të informacionit, kontrollit dhe verifikimeve të nevojshme, në figurën Nr. 4 paraqiten grafikisht të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për 29 vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe ndryshimet me vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990, të cilat evidentojnë një shmangie prej afro +0.9°C.

Disa përjashtime vërehen vetëm në zonat e larta të vendit me shmangie të vogla negative kundrejt normës.




Figura Nr.4. – Vlerat mesatare të temperaturës së ajrit për muajin korrik 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës 1961÷1990.

Ndërsa, në shkallë kontinentale ndryshimi i temperaturave mesatare të ajrit për muajin korrik 2018 paraqitet në figurën Nr. 5, ku jepen dhe anomalitë krahasuar me periudhën 1981÷2010.
















Figura Nr.5. – Vlerat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin korrik 2018 për kontinentin European dhe anomalitë përkatëse ndaj periudhës shumëvjeçare 1981÷2010, sipas NOAA-s.

Në shkallë kontinentale për anomalitë e vërtetuara në figurën Nr. 7 paraqiten të dhënat javore, ku dallohet qartë dhe situata në fjalë për territorin e vendit tonë.

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 6/1÷6/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik për muajin: Korrik 2018.






Figura Nr.7. – Anomalitë në vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit korrik 2018, sipas NOAA-s.

Temperaturat maksimale të ajrit vijuan të ruajnë një tendencë të lehtë me shmangie vlerash me rreth $+1.3^{\circ}\text{C}$ më të lartë kundrejt normës. Këto të dhëna paraqiten më të detajuara në figurën Nr.8, për disa vendmatje meteorologjike të zonave të ndryshme klimatike të vendit.




Figura Nr. 8. – Vlerat mesatare të temperaturës maksimale të ajrit për muajin korrik 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.




Figura Nr. 9.– Vlerat mesatare të temperaturave maksimale të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit korrik 2018, sipas NOAA-s.

Temperaturat minimale të ajrit ndërkohë patën shmangie përsëri pozitive, por me vlera më të moderuara kundrejt normes, prej vetëm $+0.6^{\circ}\text{C}$; të cilat paraqiten në figurën Nr.10.




Figura Nr.10. – Vlerat mesatare të temperaturës minimale të ajrit për muajin korrik 2018 për disa vendmatje meteorologjike si dhe vlerat përkatëse të normës.

Valët e të nxehtit -

mbizotëruan kryesisht në Evropën Perëndimore, ndërkohë që mot me stuhi ditore dhe reshje intensive kryesisht në orët e pasdites ishin të pranishme në shumicën e kohës në Evropën lindore duke përfshirë dhe një pjesë të mirë të vendit tonë. Valët e të nxehtit përcollën temperatura të larta të ajrit gjatë muajit korrik 2018, duke risjellë në vëmendje vitin 2003, kur u shënuan temperatura të larta deri në 45÷47°C, të cilat edhe gjatë këtij viti krijuan kushte për rritjen e numrit të zjarreve, veçanërisht jo vetëm në Portugali e Spanjë, por deri në vendet nordike. Kjo dukuri lidhet me një qarkullim të modifikuar të rrymave ajrore në lartësi (Jet streams) si pasojë e një ngrohje të veçantë të vërtetuar në shtresat e larta të atmosferës, që kushtëzoi dhe ndërkohë u shoqërua me një depërtim të masave ajrore afrikane, të cilat mbërritën me influencën e tyre deri në vendet nordike.




Figura Nr. 11. – Situata mbizotëruese gjatë muajit korrik 2018 në Evropë.

Përkundër kësaj situatë të Europës Perëndimore, vendi ynë ishte larg këtyre vlerave ekstreme të temperaturave dhe për rrjedhojë nuk pati problematikat e zakonshme të viteve të kaluara, siç kanë qenë në veçanti zjarret.

RREZIKU NGA ZJARRET

- Gjatë muajit korrik 2018 treguesi i vlerësuar sipas modeleve të ndryshme për hapësirën e vendit tonë sa i takon rriskut për zjarre ngeli në nivele mjaft të ulta (shih dhe figuren Nr.12). Vlerësimet në fjalë përgatiten dhe publikohen çdo ditë në “web site” e IGJEUM.

Figura Nr. 12. - Treguesi i rriskut nga zjarret në Europë për datën 27 korrik 2018, sipas “Copernicus EMS - EFFIS”.



Në këtë kontekst u analizua dhe një tregues i rëndësishëm klimatik, ai i numrit të ditëve me temperaturë mbi pragu 35°C, i cili për vendmatjen meteorologjike të Tiranës paraqitet në figurën Nr. 13. Për muajin korrik 2018 për Tiranën nuk evidentohet asnjë ditë, ndonëse është një nga zonat me shmangie relativisht të lartë ndaj normës për shkak dhe të efektit të “ishullit urban” (shih dhe figurën Nr. 16).




Figura Nr. 13. – Të dhënat e numrit të ditëve me temperatura të ajrit mbi pragu 35.0°C për muajin korrik 2018 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.

Temperaturat maksimale të ajrit nuk thyen rekorde dhe ishin me kohëzgjatje të shkurtër gjatë orëve të mesdites. Në figurën Nr. 14 jepen të dhënat e temperaturave maksimale absolute për 34 vendmatje meteorologjike përfaqësuese të zonave e nënzonave të ndryshme klimatike.




Figura Nr. 14 – Vlerat maksimale absolute të temperaturës së ajrit për muajin korrik 2018 për disa vendmatje meteorologjike.

NETËT TROPIKALE Gjatë muajit korrik 2018 në vendin tonë gjithnjë e më shumë po bëhen prezent netët tropikale (netët kur temperatura minimale e ajrit nuk zbritet nën pragu 20.0°C). Ndonëse ky muaj ishte relativisht me temperatura më të moderuara, nga një analizë e detajuar për këtë tregues për vendmatjen meteorologjike të Tiranës, të paraqitur në figurën Nr. 15, vërehet qartë se gjatë muajit korrik 2018 u ruajt po ajo karakteristikë si dhe në vitet e mëparshme.





Figura Nr.15 – Numri i netëve tropikale për muajin korrik, për vitet 2002 deri 2018, për vendmatjen meteorologjike të Tiranës si dhe vlerat e normës.

Duhet thënë se ky tregues për vendmatjet e tjera meteorologjike ishte më i kufizuar për shkak se temperaturat për Tiranën janë dhe nën efektin e dukurisë së “ishullit urban” dhe kështu reflektojnë dhe vlera më të larta për këtë tregues.

KLIMA URBANE – Tashmë është i njohur fakti që në qytetet e mëdha si dhe me impaktin e përcjellë nga ndryshimet klimatike, në tërësi vlerat e temperaturës së ajrit janë më të larta se ato të normës, kundrejt zonave periferike apo jashtë këtyre qendrave të mëdha urbane. Në figurën në vijim Nr. 16 jepen të dhënat për Tiranën për muajin korrik, për vitet 2012 deri 2018. Për muajin korrik 2018 ndryshimi është me plus 1.1°C kundrejt vlerave të normës; përkundërt një vlere +0.9°C, që siç u përmend më lart ishte shmangia në shkallë vendi për pjesën më të madhe të vendmatjeve meteorologjike.

Figura Nr.16 – Të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit për muajin korrik për vitet 2012÷2018 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961÷1990 për vendmatjen meteorologjike të Tiranës.



RESHJET ATMOSFERIKE Gjatë muajit korrik 2018 u vërtetua një numër më i lartë i ditëve me vranësirë dhe reshje se sa vlera e normës.

Pas përpunimit, kontrollit dhe ndjekjes rigorozë të kriterëve për analizën e reshjeve si dhe natyrisht pasi u bënë gjithë verifikimet e nevojshme të informacioneve të ardhura nga vendmatjet meteorologjike për rreth 1/3 e tyre, rezultoi se u shënuan sasi reshjesh rreth 26% më të larta në shkallë vendi se madhësitë e normës shumëvjeçare të periudhës 1961-1990. Në figurën në vijim Nr. 17 paraqiten të dhënat e reshjeve të muajit korrik 2018 dhe ato të normës.




Figura Nr. 17. – Vlerat e sasisë së reshjeve për muajin korrik 2018 për 52 vendmatje meteorologjike të vendit tonë si dhe vlerat përkatëse të normave referuar periudhës mesatare shumëvjeçare 1961÷1990.

Natyrisht këto reshje më të shumta për muajin korrik 2018, u vërtetuan përgjatë një numëri ditësh me reshje mbi pragun 1.0 mm më të lartë se vlerat e normës me rreth 33%, të cilat grafikisht paraqiten në figurën Nr. 18. Gjithashtu dhe numri i ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm rezultoi të ketë një rritje kundrejt vlerave të normës. Ai në mënyrë më të detajuar për çdo vendmatje meteorologjike paraqitet në figurën Nr. 19.




Figura Nr.18. – Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm për muajin korrik 2018 për 52 vendmatje meteorologjike të vendit tonë.





Figura Nr.19. – Vlerat e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 10.0 mm për muajin korrik 2018 për 52 vendmatje meteorologjike të vendit tonë.

Reshjet maksimale 24 orëshe u vlerësuan për çdo njëri nga 52 vendmatjet meteorologjike të analizuar (rreth 1/3 e tërësisë së vendmatjeve për këtë element meteorologjik) dhe paraqiten në figurën në vijim Nr. 20 me informacione më të detajuara krahasuar dhe me vlerat historike.



Vlerësimi i reshjeve për muajin korrik në kontinentin Europian dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981÷2010, janë paraqitur në vijim në figurën Nr.21, ku vendi ynë dallon për anomali dhe reshje mbi vlerat e periudhës shumëvjeçare kryesisht për pjesën jugore.

RRUFETË Një karakteristikë e veçantë dalluese që është theksuar veçanërisht në këtë buletin të muajit korrik 2018 ka të bëjë me rrufetë, të cilat ishin me një prani mjaft intensive gjatë ditë – netëve të këtij muaji. Bazuar në të dhënat e burimeve shkencore të qendrave evropiane për monitorimin e rrufeve, të cilat pasi u përpunuan janë paraqitur në figurën Nr.22; tregojnë për një numër të lartë prej 200 deri 400 mijë rrufesh në ditë në shkallë kontinentale.

Për vendin tonë rrufetë ishin të pranishme pothuajse çdo pasdite kryesisht pranë zonave kodrinore dhe malore duke shoqëruar stuhi kryesisht me karakter lokal dhe reshje të po asaj natyre.

Në figurën Nr. 23 - paraqiten të dhënat për rrufetë; të vërtetuara më datë: 23 & 25 korrik 2018 mbi hapësirën e vendit tonë.

Për 6 mujorin e parë të vitit 2018 situatat me rrufe shënuan rekorde në disa vende të kontinentit si p.sh. në UK muaji maj pati 68% të të gjitha rrufeve të vërtetuara, në Spanjë muaji maj pati 50% të rrufeve, ndërsa në Itali ishte muaji qershor që pati 50% të të gjitha rrufeve të vërtetuara. Po ashtu në shifra të larta vijoi dhe muaji korrik 2018.





Figura Nr.24. Rreth 70 mijë rrufe nga ora 14÷18 datë 25 korrik 2018 në kontinentin Evropian.

Temperatura mesatare në sipërfaqe të ujit, në detet Adriatik dhe Jon.

Gjatë muajit korrik 2018 temperatura në sipërfaqe të masave ujore në detet Adriatik dhe Jon shënoi vlera lehtësisht mbi normë. Për hapësirën detare të vendit tonë temperaturat ishin pranë vlerave 24÷26°C dhe paraqiten në vijim në figurat Nr. 25 dhe Nr.26.




Figura Nr.25. Temperatura e ujit të detit më datë 12 korrik 2018 (24°C).




Figura Nr.26. Temperatura e ujit të detit më datë 30 korrik 2018 (26°C).

STUHITE - Muaji korrik 2018 u karakterizua nga një numër i mesatar i stuhive sipas qendrës eksperimentale të monitorimit dhe parashikimit europian ESTOFEX.

Gjithsejt u shënuan 12 stuhi të kategorisë së parë si dhe 10 stuhi të kategorisë së dytë, të cilat paraqiten dhe në grafikun e dhënë në figurën Nr. 27.

Ndërkohë, nuk munguan dhe stuhi me karakter lokal dhe rezultat i dukurive orografike, që kryesisht u vrojtuan në zonat malore.



Figura Nr.27. Numri i stuhive të kategorisë 2, sipas viteve për muajin korrik, referuar sistemit ESTOFEX.

Sa i takon stuhive të kategorisë së tretë, ato kryesisht referuar vlerësimeve nga viti 2006 e deri më sot, tregojnë se janë vrojtuar në shumicën e rasteve në muajin korrik (10 raste), por gjatë këtij muaji korrik 2018, nuk u vrojtua ndonjë e tillë.

Sa i takon stuhive që prekën pjesërisht vendin tonë, gjatë muajit korrik 2018 ishin vetëm ato të kategorisë së parë. Një prej këtyre situatave jepet për ilustrim në figurën Nr. 28.






Figura Nr.28. Situata e pritshme për stuhi të kategorive 1, 2 dhe 3 më datë 23 e 24 korrik 2018 në kontinentin Europian.

Temperaturat e ajrit Bazuar në informacionet e përgatitura nga qendra SEEVCCC për temperaturat e ajrit për periudhën në vijim që përfshin muajt gusht, shtator dhe tetor 2018 vlerësimet tregojnë vlera pranë normës ose paksa mbi të në zonën e ulët të vendit tonë (shih figurën Nr.29).



Reshjet – Anomalitë e reshjeve për muajt gusht, shtator dhe tetor 2018 tregojnë për një tendencë rënie dhe vlera të pritshme nën normë. Në figurën Nr. 30 jepen vlerat e anomalive në % përkundërt normës për këtë periudhë tremujore.



PERIUDHA JANAR – KORRIK 2018 ME RESHJE REKORDE NË 15 VITET E FUNDIT.

Muajve, javëve dhe ditëve të fundit jemi dëshmitarë të anomalive të motit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike në nivel global. Vapa që po mbretëron kësaj vere në Evropën veriperëndimore tash disa javë e që pritet të ketë kulminacionin ditëve në vazhdim me temperatura rekorde të regjistruara ndonjëherë në Evropë, deri në +50°C që pritet të ndodhin në gadishullin Iberik (Spanjë dhe Portugali), në Gadishullin Ballkanik si asnjëherë më parë ka rezultuar me sasi rekorde reshjesh që ka reflektuar edhe me temperatura nën mesataret e pritshme. Anomalitë në vendin tonë (Kosovë) këtë vit kanë filluar që në muajin Prill 2018, i cili me temperaturën mesatare prej (14.8°C) ka tejkaluar të gjitha mesataret mujore (Prill) të regjistruara që nga viti 1961; por edhe në nivel global ky muaj është shënuar si muaji Prill më i nxehtë që kur kanë filluar matjet zyrtare meteorologjike në shekullin e 19-të. Matjet e gjertanishme në Departamentin Meteorologjik në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) të Republikës së Kosovës japin një sasi totale të reshjeve për periudhën Janar – Korrik 2018 (683.5 l/m²), sasi kjo që ka tejkaluar sasitë totale vjetore për 10 nga 15 vitet e fundit, dhe madje ka tejkaluar edhe mesataren vjetore për 15 vitet e fundit (2003-2017) – 654.4 l/m², shih tabelën në të djathtë.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

	Tot. vj. Tot. Ann.	Max. muj. Month.Max.	Mes. muj. Month.Av.	Min. muj. Month.Min.
2003	632.2	138.3	52.7	22.3
2004	774.2	125.7	64.5	30
2005	676.3	100.7	56.4	9.2
2006	706.9	122	58.9	26.7
2007	610	115	50.8	6.4
2008	596	121.9	49.7	3.5
2009	653.7	92.5	54.5	15.6
2010	829.6	113.7	69.1	7
2011	446.7	88.2	37.2	4.2
2012	488.3	108.5	40.7	3.5
2013	626.6	115.2	52.2	11.8
2014	812.8	165.9	67.7	3.7
2015	631.1	112.4	52.6	2.7
2016	807.7	114	67.3	1.1
2017	644.4	117.9	53.7	18.5



Figura Nr. 31 – Pamje të datës 27 korrik 2018, pranë aeroportit, Prishtine, Kosovë. (foto nga: Arben Bytyqi).


Muajt Maj, Qershor dhe Korrik 2018, për nga sasia e reshjeve kanë shënuar vlerat rekorde që tejkalojnë dukshëm mesataret e muajve përkatës: – Maj 2018 – 125.6 l/m²; mes. vjetore (Maj 2003 -2017) – 77.2 l/m², – Qershor 2018 – 188.6 l/m²; mes. vjetore (Qershor 2003 -2017) – 76.5 l/m², – Korrik 2018 – 149.5 l/m²; mes. vjetore (Korrik 2003-2017) – 35.5 l/m². Madje totali i tremujorit: Maj, Qershor dhe Korrik 2018 prej 463.7 l/m² tejkalon totalin e sasisë së reshjeve vjetore për vitin 2011 – 446.7 l/m². Vlerat e cekura më lartë dhe rekordet e shënuara vërtetojnë dhe janë një dëshmi e fortë se ndryshimet klimatike tashmë po vërehen edhe në vendin tonë dhe përveç dëmeve të shkaktuara në fushën e agronomisë do të ndikojnë edhe në sferat e tjera jetësore që do të detyrojnë qytetarët të ndryshojnë stilin e jetës dhe të kërkojnë mundësi për adaptim me rrethanat e reja.

Përgatitur nga: Sherif Gosalci – Menaxher i Departamentit Meteorologjik në Aeroportin e Prishtinës, Kosovë.

Disa nga dukuritë që u evidentuan gjatë muajit korrik 2018 mbi kontinentin Evropian si dhe mbi vendin tonë ishin si vijon:

Minimumi i Njollave Diellore – Më 31 korrik 2018 Dielli u karakterizua për 34 ditët që e paraprinë këtë datë nga 33 ditë pa njolla. Një situatë e ngjashme i takon vitit 2009, kur në Diell u vërtetua një nga minimumet sa i takon këtij treguesi për gjithë shekullin. Natyrisht me minimumin e njollave diellore theksohet dukuria e një rrezatimi ekstra kozmik dhe aurorat. Në figurën Nr.32 paraqitet një nga pamjet tipike të Diellit pa njolla në të, sipas NASA-s gjatë muajit korrik 2018.

Figura Nr. 32. Pamje e Diellit më datë 31 korrik 2018.



Rrufetë Të pranishme në orët e pasditës pothuajse në shumicën e ditëve ato ishin një karakteristikë e veçantë shoqëruese për muajin korrik 2018. Pamja në figurën Nr.33 paraqet mbi 75 mijë rrufe të vërtetuara në 4 orët e fundit 17:15÷21:15 të datës 27 korrik në kontinentin tonë, ndërsa ajo në figurën Nr.33 pamje nga rrufetë mbi Tiranë në ora 15:04 të po kësaj date.




Figura Nr.32. Rrufetë e vërtetuara më datë: 27 korrik 2018 ora 21:15, kontinenti Evropian.



Figura Nr.33. Datë: 27 korrik 2018 ora 15:04 Tiranë, pjesa JL e qytetit. (foto: P. Zorba).

Eklipsi i Hënës - Më datë 27 korrik 2018 nga ora 21 e 30' deri 23 e 13' u vërtetua një nga eklipset më të gjatë të Hënës, në shekull (me zgjatje 1 orë e 43 minuta), i cili u vërtetua dhe në vendin tonë.

Figura Nr.34. Pamje nga eklipsi i Hënës transmetuar direkt nga NASA TV.



Hëna dhe eklipsi ishin të mundur të shikoheshin dhe me sy të lirë, së bashku me planetin Mars, pasi



atmosfera ishte e pastër, ndonëse vetëm një vranësirë e lehtë u vërtetua pak minuta para se të vërtetohej fillimi i kësaj dukuri mbi Tiranë. Më datë 31.07.2018 Marsi u ndodh në pikën më të afërt me Tokën në një distancë prej 57.6 milion km.

Figura Nr.35. Pamje e Hënës në momentin kur fillon largimi i hijezimit të krijuar nga Toka. Në foto përfshihet dhe planeti Mars. (foto: P. Zorba).

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.

To read the other bulletins you are welcome to visit the respective web site, by clicking on the link of IGEWE.



<http://www.geo.edu.al>

Editorial Board:

Prof.Dr. Petrit ZORBA - Head of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Prof.Dr. Sylë TAHIRSYLAJ - University of Prishtina – Republic of Kosova.

Dr. Elvin ÇOMO - Member of the Department of Climate and Environment UPT – IGEWE

Subject Editors (Co-Editors):

Dr. Entela Gavroçi, Institute of Applied Nuclear Physics, Tirana University, Albania.

External Reviewers:

Dr. José A. GUIJARRO - AEMET – Madrid, Spain.

Editorial Board approved by the Director of IGEWE – Prof.Assoc.Dr. Fatos HOXHAI

Ky buletín u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Klimës & Mjedisit të IGJEUM sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Climate & Environment by rubrics as follow:

Data digitalization: A. Hasimi, A. Bardhi, A. Gjoni & UPT student (M.Sc.) V. Dervishaj.

Data control, verification and elaboration by appropriate software: Prof. P. Zorba, Ing. A. Gjoni.

Evaluation of monthly synoptic situation: M.Sc. M. Marku.

Evaluation of monthly meteorological characteristics and climate change: Prof. P. Zorba.

“Mot i veçantë për muajin korrik 2018 dhe në Kosovë”. Përgatitur nga: Sherif Gosalci – Menaxher i Departamentit Meteorologjik në Aeroportin e Prishtinës, Kosovë.

Scientific information: About Suns spots, Lightning & Moon Eclipse observed on July 2018 has been prepared by Prof. P. Zorba.



“Buletin Mujor Klimatik”
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2018.

